

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Constitutional Paragraph: Neni 45 para 3

Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 25

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; (b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.

Neni 21

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

1. Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejtë ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Secili ka njësoj të drejtë të hyjë në shërbimet publike të vendit të vet.
3. Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhjet e herëpashershme dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe me votë të barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

Ligjet

Nenet

LIGJI NR. 03/L-040
PËR
VETËQEVERISJEN
LOKALE,
LIGJI NR. 03/L-040
PËR
VETËQEVERISJEN
LOKALE,

68.1 Çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë përpara. Njëra nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. 68.2 Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal. 68.3 Përveç takimeve publike të cekura më lartë, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës. 68.4 Kuvendi i komunës miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislativë, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës. Ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale mund të nxjerrë udhëzime administrative për transparencë komunale. 68.5 Çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 25

Të drejtat politike

1. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete politike dhe të shprehë bindjet partiake vetëm jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucionit publik.
2. Nëpunësja/i civil me përjashtim të nëpunëses/it civil të kategorisë së nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues, mund të jenë anëtare/ë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtare/ë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të një partie politike.
3. Nëpunësja/i e shërbimit publik dhe nëpunësja/i teknik dhe mbështetës mund të jenë anëtare/ë të partive politike dhe anëtare/ë të organeve drejtuese të një partie politike, me përjashtim të nëpunëses/it së shërbimit publik të nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues, të cilët mund të jenë anëtare/ë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtare/ë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të një partie politike.
4. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës apo për organet komunale, përveç kur përcaktohet ndryshe me ligj.
5. Zyrtarja/i publik, e cila kandidon për zgjedhjet qendrore ose lokale, duhet të pezullojë pa pagesë vendin e punës shtatë (7) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës. Pezullimi përfundon pesë (5) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës.
6. Në rast të zgjedhjes në Kuvendin e Republikës së Kosovës, zyrtarja/i publik, i cila pranon mandatin, pezullon marrëdhënien e punës prej datës së certifikimit të zgjedhjes së kandidatit deri në përfundim të mandatit përkatës, përjashtimisht stafit akademik universitar (profesore/i i/e rregullt, profesore/i i/e asociuar, profesore/i asistent, profesore/i, ligjërues/e, asistent/e) dhe profesionistëve shëndetësor.
7. Përjashtimisht, pezullimi në kuptim të paragrafit 6. të këtij neni, nuk mund të bëhet për pozitat të cilat janë me mandat.
8. Pas përfundimit të mandatit si i zgjedhur sipas paragrafit 6. të këtij neni, zyrtares/it publik i garantohet marrëdhënia e punës në institucionin ku ka qenë në marrëdhënie pune ose në një institucion tjetër, në pozitë të njëjtë ose ekuivalente, me kusht që plotëson kriteret për caktimin në pozitën në fjalë.

Ligji nr. 08/1-197 për
zyrtarët publik
Ligji nr. 08/1-197 për
zyrtarët publik

decisionTitle* **decisionDescription***

Guerra k. Italisë

Në rastin Guerra dhe të tjerët, Gjykata vërtetoi se Italia e kishte shkelur nenin 8, në aspektin e jetës private dhe familjare, lidhur me atë se kishte dështuar në informimin e popullatës lokale rreth faktorëve të rrezikut dhe rreth mënyrës së veprimit në rast të ndonjë aksidenti në fabrikën kimike që gjendej në afërsi. Paditësit shprehimisht i kishin kërkuar ato informata nga autoritetet kompetente vendore. Ato përfundimisht ishin dhënë vetëm pas mbylljes së prodhimit industrial.

Namat Aliyev v. Azerbaijan, no. 18705/06, § 77, 8 April 2010.

Namat Aliyev
v. Azerbaijan

Aplikantët, kandidatë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, ishin regjistruar vonë pas vendimeve të pretenduara fillestare arbitrare që refuzuan t'i regjistronjë ata si kandidatë dhe thirrjet e tyre pasuese, duke i lënë ata një kohë shumë të shkurtër për të zhvilluar fushatat e tyre elektorale përkatëse. Aplikuesi i parë kishte vetëm një ditë të plotë për fushatë, aplikanti i dytë kishte vetëm tre ditë të plota, dhe aplikanti i tretë praktikisht nuk i ishte lënë kohë për fushatë. Regjistrimi në kohë i kandidatëve ishte thelbësor në mënyrë që ata të njiheshin për votuesit dhe të jenë në gjendje të përcjellin mesazhin e tyre politik gjatë periudhës së fushatës elektorale në përpjekje për të fituar vota dhe për t'u zgjedhur. Procedurat në çështjet aktuale iu nënshtruan një numri të vonësave që i atribuohen komisioneve zgjedhore dhe gjykatave, të cilat në disa raste kishin dhënë vendimet e tyre përkatëse në mënyrë të vonuar, ndonjëherë në shkelje të kufirit tre-ditor të përcaktuar me ligj. Vonesat në regjistrimet e aplikantëve nuk ishin të vogla. Aplikantët ishin regjistruar aq vonë dhe aq afër ditës së zgjedhjeve sa që ata nuk kishin një kohë të arsyeshme për të kryer fushata elektorale efektive. Regjistrimi i vonuar ishte për shkak të mungesës së masave mbrojtëse ndaj arbitraritetit në procedurat e regjistrimit të kandidatëve dhe vonësave në shqyrtimin e ankimeve të tyre nga autoritetet zgjedhore dhe gjykatat. Në rrethana të tilla, të drejtat elektorale të aplikantëve ishin kufizuar në atë masë sa të dëmtojnë ndjeshëm efektivitetin e tyre.